ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-23-9615-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" Kompania Prishtina " Sh.p.k**
NUI	**600109723**
Adresa	**SELMAN RIZA NR.10**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044/163500**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**RIZAH AZEMI**
Adresa elektronike	**kompania-prishtina.shpk@hotmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**05.01.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve

Njoftimi per kontrate me date 21.09.2023

Dokumenti shtojca 22.09.2023&28.09.2023

Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje me date 03.11.2023 14:00

Hapja e tenderit 03.11.2023 14:00

Njoftim mbi vendimin me date me date 20.12.2023 15:11

Kerkese per qasje ne dokumentacion te fituesit me date 22.12.2023.

Qasje ne dokumentacion te fituesit me date 22.12.2023 .

Kërkesa për Rishqyrtim me datë 26.12.2023

Vendimi i AK në kërkesën për Rishqyrtim datë 29.12.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Në rregullë ka qenë procesi i hapjes.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Pas pranimit të vendimit të AK si përgjigje në kërkesën tonë për Rishqyrtim me të cilin vendim AK në kundërshtim me dispozitat e LPP-së e refuzon kërkesën tonë për Rishqyrtim, në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe ne afat ligjor paraqesim ankesë në OSHP me pretenimet ankimore se AK ka shkel dispozitat e LPP-së si në

vijm:

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së-Qëllimi

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së- Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 61 i LPP-së -Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Neni 69 i LPP-së - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 41-Rregulloren Nr.001/2022 per Prokurim Publik

Neni 10-Udhezuesit Nr. 001/2023 Per Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të njëjtat pretendime ankimore qe kemi parashtruar në Kërkesën për Rishqyrtim do të prezentojm edhe në këtë ankesë, vetëm do ti kundërshtojm përgjigjet e AK-së të dhëna në vendimin e datës 29.12.2023 me të cilin ka refuzuar pretendimet tona ankimore rrjedhimisht edhe Kerkesen per Rishqyrtim si te pa bazuar.

Pretendimi 1.

Grupi OE i propozuar me kontratë sipas vendimt Date 20.12.2023, ka bëre ndërhyrje në paramasë dhe parallogari në kundërshtim të plotë me ligjin e LPP-së, UPP Nr. 001/2023 dhe RRPP **Nr.001/2022**

GOE me rastin e ofertimit ndërhyn në paramasë duke ndryshuar sasinë tek Punët e Instalimeve gjegjësisht 4.Makineria-2.0.Instalimet e Brendshme, posicioni 2.

Sipas FDT-së Pjesa e II-të, sasia në paramasë është 0.40 %,kurse nga GOE është ndërhyr në kundërshti të plotë duke zvogluar në 0.04%.

Sipas GOE-së "Standard Beton" me te tjerë, me rastin e ofertimit, respektivisht të plotësimit të paramsës në pozicionin e theksuar me lartë dhe të ilustruar më poshtë me ngjyrë ka ndëryhrë (ka ndryshuar) paramsën e dhënë nga AK prej 0.4 % dhe e ka bërë 0.04 %. Shih më poshtë paramasën e OE të rekomanduar për kontratë si e ka ndryshuar.

	DN65	m	90	14.50	1,305.00
2	Fitingje per instalimin e sistemit gypor per furnizim te uje te ngrohet dhe ftohet si dhe elementet mbajtse dhe shtanguese, kthesat, reduktuesit, mbajtës, teli, gazi për saldim,flanxhed,dado,bulona etj) 40% nga pozicioni 1	%	0.04	4,488.60	179.54
	Izolimi i gypave te çelikut meArmaflex				-

Ndërsa në tabelën tjetër që është dhënë në dosjen e tenderit. Sipas FDT-së Pjesa II-të, respektivisht në paramasën e AK të ngarkuar në sistemin e-prokurimi ky pozicion ka qenë 0.4 % . Shih më poshtë tablën me me pozicionin përkatës me vlerën e rrethuar me ngjyrë.

64	DN65	m	90		-
65 2	Fitingje per instalimin e sistemit gypor per furnizim te uje te ngrohet dhe ftohet si dhe elementet mbajtse dhe shtanguese, kthesat, reduktuesit, mbajtës, teli, gazi për saldim,flanxhed,dado,bulona etj) 40% nga pozicioni 1	%	0.40	-	-
66	Izolimi i gypave te çelikut meArmaflex				-

Pra shihet qartë që OE i rekomanduar për kontratë ka ndërhyrë dhe ka ndryshuar qëllimisht paramasën e AK, pjesë e cila është e njëjtë për të gjithë ofertuesit. Me këtë rastë është shtrembruar konkurenca në mes të tenderuesve sepse për të gjithë tenderuesit ky pozicion ka qenë me vlerë prej **0.4 %**, ndërsa për OE fitues me vlerë **0.04 %** që i bie **10 herë (fish) me e vogël** se që është dhënë në DT. Pra OE fitues është dashtë të plotësoj **vetëm fushat e zbrazta në paramasë e <u>jo të ndryshoj vlerat</u>** të cilat janë dhënë në

dosjen e tenderit nga AK.

Nga kjo rezulton se OE fitues nuk e ka plotesuar paramasën (ofertën) siç duhet, me qëllim ka ndryshuar vlerat e dhëna në DT. AK këtë rast **është munduar ta arsyetoj si gabime aritmetike të OE fitues**. Mirëpo këtu nuk kemi të bëjmë me asnje gabim aritmetik sepse vlerat janë të llogaritura saktë mirëpo të dhënat në paramasë janë të ndryshuara nga OE fitues dhe kalkulimet janë llogaritur saktë sipas të dhënavë të ndryshuar e jo nga ato reale siç jane në paramasën e DT. Prandaj kjo nuk mundet të vlerësohet si gabim aritmetikor të llogaritur, siç e ka vlerësuar AK.

Po ashtu Rreg.Nr. 001/2022 pika 40.10 nën (b) thotë:

b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, ***oferta refuzohet****.* Pra oferta e OE fitues ka mos perputhje te çmimit mes Formularit te tenderit dhe totalit në Pershkrimin e çmimit pas korigjimit. Prandaj kjo oferte duhet te refuzohet si e pa përgjegjëshme.

Pra kjo nderhyrje konsiderohet si ndryshim i paramasës dhe si i tillë, formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet dhe duhet te **refuzohet oferta** siç e theksohet në tabelën e me poshtëm të Rreg Nr. 001/2002.

Problemi	**Si të veprohet?**	**Neni i LPP-se**
Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	**Refuzo** tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	**Kusht administrativ**

Konform LPP-së neni 59 ,UPP Nr. 001/2023 Neni 10 dhe Rreg. Nr.001/2022 neni 40.6, pika (b) dhe 40.7 pika (iv), theksohet se tenderi konsiderohet i përgjegjshëm kur:

b. *është në pajtueshmëri në* ***termet teknike me përshkrimin****, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit.*

Që në këtë rast **përshkrimi** dhe termat teknike në pozicionin e theksuar me lartë në paramasën e OE fitues **nuk janë në Pajtueshmeri** me Dosjen e tenderit dhe

Pika 40.7 (iv) e Rreg. Nr. 001/2002 thotë se *të qenit në pajtueshmeri nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve*

*administrative dhe teknike të **parashtruara në dosje të tenderit** duke mos u*

larguar në mënyrë thelbësore nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

"Largimet dhe Kufizimet thelbësore janë ato të cilat:

*(iv) **Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve**, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat.*

Në rastin konkret OE fitues ka bërë ndryshimet e vlerave në pozicionin e theksuar më lartë të paramasës në dosjen e tendrit, ka **shtrembruar konkurencë** e tenderuesve.

Prandaj është e quditëshme pse AK ne vendimin e datës 29.12.2023 si përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim nuk e ka marrë si të **bazuar** këtë pretendim ankimor por në kundërshtim të plotë me Nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40.6 pika (b) 40.7 pika (iv) te Rregu.Nr.001/2022 refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim si të pa bazuar. Kërkojm nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli i OSHP që ky pretendim ankimor të shqyrtohet në përputhje me këto dispozitat të LPP dhe akteve dytësore që i përmendëm më lartë.

<u>Pretendimi 2.</u>

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë te kërkesat

Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

1.

2. OE duhet të paraqes Një (1) Menaxher të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë punë pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë sepaku 1 projekte të perfunduara.

Dëshmia e kërkuar dokumentare ka qenë:

1. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e njoftimit për kontratë , CV , kontratae e punës valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi, Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).

2. **Kapaciteti teknik dhe profesional** është kërkuar:

3. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

4. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndertimtarisë drejtimi Konstruktiv - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

5. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndertimtarisë drejtimi Hidro - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

7. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektronikës drejtimi automatik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

8. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Gjeodezisë - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare per 3,4,5,7,8 ka qenë:

3. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).

Grupi i Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka paraqitë si menaxher të projektit znj.Mimoza Mehmetaj për ing.te diplomuar te arkitekturës znj.Amantina Prushi,për Ing.i diplomuar te ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv z.Genc Samini,për Ing.i diplomuar të ndërtimtarisë drejtimi Hidro znj.Myzejen Papa,për Ing.i diplomuar të Elektroteknikës drejtimi Automatik z.Blenard Agushi si dhe Ing.i diplomuar të Gjeodezisë z.Bledar Mihaj,të gjithë **shtetas te Republikes se Shqiperisë**.

Stafi i paraqiturë nga Grupi i OE i rekomanduar për kontratë, **nuk kan diploma valide për të punuar në Kosovë si shtetas të huaj.** Sepse sipas ligjit **Nr 04/L-037** për **Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves**, neni 6 dhe Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 12-2018 *Parimet dhe procedurat e njohjes se diplomave gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës,* thekson shumë qartë te:

Neni 3, paragrafi 1.

*Te gjitha diplomat e shkollave te larta profesionale si dhe ato univerzitare te fituara jashte vendit me **qellim punesimi**,do t'u nenshtrohen procedurave te njohjes /barasvleres*

ne MASHT.

Neni 3, paragrafi 6.

*Shtetasit e huaj me qellim punesimi ne Republiken e Kosoves,jane te **obliguar** te kerkojne njohje dhe barasvlere te diplomave dhe kualifikimeve te arsimit te larte te fituara jashte venit.*

Duke ju referuar ligjit më lartë dhe Udhëzimit Administrativ ,grupi i OE-ve i rekomanduar për kontratë me rastin e ofertimit për stafin e elaboruar më lartë shtetas te Republikës së Shqipërisë të punsuar në Kosovë do të duhej të paraqitnin diplomat e NOSTRIFIKUARA nga MASHTI konform ligjit dhe udhëzimit Administrativ.

Mbi këtë bazë ligjore, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka fare menaxher të projektit me **diplomë të njohur në Kosovë** njashtu dhe stafin profesional dhe si i tillë ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për menaxher të Projektit dhe stafin profesional të kërkuar sipas FDT dhe njoftimit për kontratë të theksuar më lartë.

Pra mos përmbushja e këtij kriteri të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë e bënë OE të **Pa përgjegjshëm** dhe obligativisht duhet të **eleminohet** nga komisioni i vlerësimit të ofertave në AK.

Kërkesa e dosjes thekson se **duhet të këtë diplomë**, kjo nënkupton që diploma duhet të jetë valide sepse në të kundërtën nuk mundet të ofertohet në tender me dokumente jo valide.

Në rastin konkret që GOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar diplomën **jo valide** te Menaxherit Projektit dhe stafit Profesional, te cilat diploma sipas ligjeve në Kosovë **nuk pranohen te panostrifikuara**, rrjedhimisht GOE i rekomanduar për kontratë në bazë të ligjit arsimit në Kosovë nuk e ka Projekt Menaxherin të diplomuar dhe stafin profesional sipas kërkesave në FDT dhe njoftimin për kontratë.

Prandaj **AK ka shkelë nenin 69** të LPP-së pika 6.1 *kualifikimet shkollore dhe profesionale të përsonelit udhëheqës të operartorit ekonomik* **sepse** ky kualifikim (diploma) kanë qenë kriter përzgjedhës e kërkuar në dosjen e tenderit të cilën GOE i

rekomanduar për kontratë **nuk e ka plotësuar** dhe si i tillë është dashtë të shpallet i **pa përgjegjshëm.**

Mos respektimi i këtijë kriteri nga AK ka ndikuar edhe në shkeljet tjera të dispozitave të LPP-së siq janë neni 59 sepse njoftimi i kritereve të përzgjedhjes që paraqitet në dosjen e tenderit, të njëjtat kritere duhet të plotësohen nga GOE por në këtë rast nuk është plotësuar një kriter.

Është shkel neni 59 i LPP sepse nuk është bërë vlerësimi i tenderve sipas këtijë neni ku theksohet se OE duhet ti plotësojnë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit për tu shpallë i përgjegjshëm, e në këtë rast GOE i rekomanduar nuk e ka plotësuar këresën për diplomë.

AK në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim thekson se **nuk po e kuptojme këtë pretendim se për çfarë nostrifikimi është fjala dhe nuk jep pergjigje konkrete përmbajtësore**. Është shumë e qarte që anëtari i konzorciumit fitues, respektivisht zyrtrët e tijë nuk i kanë diplomat e nostrifikuara sipas ligjit **Nr 04/L-037** për **Arsimin e Larte ne Republiken e Kosoves**, neni 6 dhe Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 12-2018 dhe si të tillë nuk munden të prezentohet në këtë tender për plotësimin e kerkesave të stafit. Prandaj kjo ofertë është e pa përgjegjëshme edhe për këtë arsye sepse pa këtë staf të anëtarit të konzorciumit fitues, nuk përmbushen kërkesat e DT nga grupi i Operatroreve fitues..

<u>Pretendimi 3.</u>

Grupi i Operatorëve ekonomik i propozuar për kontratë ,me qëllim të manipulimit të ofertës finale ka përdore çmime JO NORMALISHTË të ulta dhe manipulative.

Grupi i Operatoreve ekonomik në fjalë me qëllim të manipulimit të ofertës si dhe tendencës për mos **Kompletim te Projektit** ka përdorë çmime abnormalisht të ulta në pjeset kurciale të kompletimit dhe funksionalizimit të projektit.

Në vazhdim po ju paraqesim posicionet e manipuluara me çmime abnormalisht të ulta:

.Pos sipas ofertës tek Rikonstruimi i objektit të QRA-QPD në Ferizaj:

-Punët e dyshemesë me pos 9.1dhe 9.7;

-Punët e zdrukthëtarisë me posicione :Pos 10.3-a dyert automatike

.Pos sipas ofertës tek NDËRTIMI I ANEKSIT PËR OBJEKTIN E QRA-QPD NË FERIZAJ:

-Punët e dyshemesë me pos 11.1,11.7 dhe 11.8;

-Punët e zdrukthëtarisë me posicione :Pos 12.3-a dyert automatike; Pos 12.5-b sportelet

-Punët fasadës me posicione 13.3 .

-Punët matalike me posicione 15.1

-Punët e inst.elektrike-gjeneratorit dhe UPS me pos 1 ;

Edhe pse nga komisioni vlerësuaes është zhvilluar procedura për tenderët jonormalisht të ulët,sipas konstatimit tonë GOE duke marrë për bazë vlerën e nevojshme për ekzekutim nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme konform **Nenit 41 -nga RRPP Nr.001/2022 .**

Për të gjitha këto posicione mundësit minimale për realizim është referencë oferta jone.

Edhe per kete pretendim AK ne pergjigje te kerkeses per rishqyrtim ka thene se jane ndermarre veprimet sipas Rreg. Nr.001/2022 neni 41. Mirëpo kjo fare nuk është e vërtet sepse AK nuk ka marrë për bazë çmimet jo normalishtë të ulëta për pocicionet qe ne kemi theksuar në ofertën e OE fituese, sidomos kërkesat e nenit 41.8 që lidhen me ekonominë e procesit prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit që tani çmimet janë rritur shumë dhe janë në trend të rritjes edhe më tutje.

Si përfundim të kësaj ankese bazuar në pretendimet e dhëna dhe dëshmit e ofruara më lartë, kërkojmë nga OSHP të marrë:

VENDIM

- **Aprovohet** si e bazuar ankesa e OE "Kompania Prishtina" SHPK
- **Anulohet** Vendimi i AK i datës 29.12.2023 si i kundërligjshëm
- Të bëhet **Rivlerësimi** i ofertave dhe të rekomandohet për kontrata oferta jonë si oferta e përgjegjëshme dhe me çmim më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme materiale janë shpenzimet e bërë për përgaditjen e ofertës, koha dhe fitimi humbur nëse fitohet kontrata që mundet të jetë rreth 15 % të vlerës së ofertës tonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*